

Konferenca Rajonale

“Roli i grave në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çojnë në terrorizëm (VERLT) në Ballkanin Perëndimor”

Fjala e hapjes e ambasadorit Vincenzo Del Monaco, Kreu i Prezencës së OSBE-së

14 tetor 2021

I nderuar zëvendësministër Nikolla, e nderuar zonja drejtore Dervishi, Koordinatori Kombëtar nga Maqedonia e Veriut, të nderuar të ftuar e pjesëmarrës!

Kam kënaqësinë që të hap konferencën e sotme. Kur pashë programin, thashë me vete: këta jemi ne, kjo është vërtet OSBE-ja në veprim si një e tërë: duke shqyrtuar një çështje të sigurisë nga këndvështrime të shumta e të ndryshme, duke e vendosur atë në dimensionin njerëzor, të shtetit ligjor, në dimension rajonal dhe ndërkombëtar. Pikërisht këtu, në Tiranë, së bashku me partnerët tanë nga qeveria dhe qendra CVE, një partneritet i vërtetë.

Të dashur miq,

Tema e sotme ka një **rëndësi, aktualitet dhe kompleksitet të shkallës më të lartë.**

Rëndësi, sepse sipas një studimi të publikuar në janar të këtij viti nga Instituti Shqiptar për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 1 353 burra, gra dhe fëmijë nga Ballkani Perëndimor u larguan për në Siri dhe Irak në pesë vitet e fundit. Afërsisht 15 përqind e atyre që u larguan nga Ballkani Perëndimor për të luftuar për grupet ekstremiste ishin gra. Ne e dimë se në Shqipëri familje të tëra u larguan të gjithë së bashku, me gra dhe fëmijë, që iu bashkuan burrave dhe baballarëve të tyre. 79 meshkuj, 27 gra dhe 38 të mitur bënë pjesë në këtë kategori. Ashtu si kudo në botë, zonat ku jetonin këto familje shërbyen si “terreni” i duhur duke qenë të gjitha të prekura nga radikalizmi fetar.

Aktualitet, sepse një numër në rritje i ish-mbështetësve të ISIS-it po kthehen sërish në rajonin e OSBE-së edhe tani që po flasim. Sipas procedurave ku më shumë e ku më pak të organizuara. Në këtë pikë, Shqipëria meriton të përshëndetet që, në mënyrë transparente, duke qenë plotësisht e vetëdijshme për rreziqet, po kryen riatdhësimin e grave dhe të fëmijëve nga Siria, duke i vendosur menjëherë në programe të ndihmës mjekësore dhe të mbështetjes psikologjike, si edhe duke i vënë nën mbikëqyrjen e duhur.

Kompleksitet, sepse një studim i Qendrës së Gruas për Zhvillim dhe Kulturë, dhjetorin e kaluar, zbuloi se faktorët kryesorë, që ndikojnë në pjesëmarrjen e grave shqiptare në zonat e luftës, përfshijnë nivele të larta të marginalizimit social, një pushtet vendor të dobët në zonat rurale dhe përjetim të dhunës në familje, krahas diskriminimit me bazë gjinore në vendin e punës dhe pabarazisë së përgjithshme gjinore, që prek gratë.

Thënë kjo, gratë nuk mund të trajtohen thjesht si viktima. Disa prej tyre janë të tilla, të tjera nuk janë. Shumë syresh, përfshirë edhe nga rajoni ynë, kishin role të rëndësishme në radhët e organizatës terroriste ISIS. Roli i grave si anëtare të grupeve terroriste, ose si ekstremiste, shpesh reduktohet në një qasje stereotipikisht të thjeshtëzuar, që i përshkruan gratë si shoqëruese të familjes apo si anëtare jo të rëndësishme të grupeve terroriste. Kjo injoron rolin aktual të grave në organizatat terroriste. Çka jo vetëm paraqet rrezik për sigurinë, por gjithashtu vë në rrezik drejtësinë. *Justicia* është gjinia femërore. Gratë duhet të përballen me drejtësinë njësoj si burrat.

Në të njëjtën mënyrë, duhet të pranohet dhe kuptohet roli i grave në luftën aktive dhe me sukses që zhvillohet kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit. Përmes punës së tyre në organizatat komunitare, lidhjes me shkollat dhe familjet, gratë priren të jenë të parat që identifikojnë simptomat fillestare të sëmundjes së radikalizimit dhe që gjejnë mënyrat për të zgjidhur problemin para se të jetë vonë.

Dhe kjo, të nderuar kolegë, është ajo që ne - ju - jemi këtu për të diskutuar sot: rolet e ndryshme aktive dhe pasive të luajtura nga gratë në kontekstin e radikalizimit dhe organizatave terroriste. Si edhe përfundimet që do të duhet të nxjerrim për hartimin e politikave të duhura. Në dritën e qasjes tërësore që ndjek OSBE-ja për sigurinë dhe shoqërinë si një e tërë.

Konferenca e sotme është një platformë e shkëlqyer për hartuesit e politikave, specialistët e fushës dhe akademikët për të vlerësuar në mënyrë të plotë rolin e grave në ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizëm, në rrethanat konkrete të Ballkanit Perëndimor. Ju lutemi, ndani përvojat tuaja në mënyrë që të gjithë të mësojmë nga njëri-tjetri.

Jam i bindur se nga kjo konferencë do të dalim me sugjerime konkrete dhe praktike se si të hartojmë politika dhe ndërhyrje efektive në luftën kundër dhunës dhe radikalizimit, për parandalimin, ndjekjen penale dhe rehabilitimin, bazuar në analiza dhe të dhëna që mbajnë parasysh karakteristikat gjinore.

Me këtë, ju uroj diskutime të frytshme dhe mbetem në pritje të analizave dhe të rekomandimeve tuaja.

Shumë faleminderit!